## Titulli i lëndës: <u>Shkathtësi komunikuese</u>

| **Informatat themelore për lëndën** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | FIEK |
| **Titulli i lëndës:** | Shkathtësi komunikuese |
| **Niveli:** | Baçelor |
| **Statusi i lëndës:** | Obligative |
| **Viti i studimeve:** | I – Semestri 1 |
| **Numri i orëve në javë:** | |
| **Kreditë ECTS:** | |
| **Koha / Vendi:** | |
| **Mësimdhënësi:** | Prof. Dr. Sabrije Osmanaj |
| **Të dhënat kontaktuese:** | sabrije.osmanaj@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Lënda paraqet konceptet themelore te komunikimit në kohen digjitale. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Aftësimi i studentëve për t'u shprehur drejt me gojë dhe me shkrim, për punë në grup dhe për paraqitje publike. |
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje: (1) të shkruajë letra të ndryshme zyrtare dhe afariste; (2) të shkruajë emaila formalë dhe joformalë; (3) te shkruaj postime për rrjetet sociale, (4) të shkruajë raporte të ndryshme (vizitash, terreni, fizibiliteti; progresi etj.) (5) të shkruajë raporte laboratorike; (6) të përdorë Internetin për gjetjen e informacionit të caktuar; (7) të përdorë kompjuterin për të shkruar raporte të ndryshme; (8) të shkruajë procesverbale nga mbledhjet/takimet; (9) të hartojë një punim/ese lidhur me një problematikë a çështje të caktuar; (10) të shkruajë CV-të dhe aplikacionet/ kërkesat për punë; (11) të mbajë prezantime me gojë; (12) të përgjigjet në intervista për punë. |
| **Rëndësia dhe aktualiteti i lëndës** | Lënda konsiderohet si tejet e rëndësishme për të komunikuar në grup dhe shprehur te arriturat profesionale. |

| Total | | | 120 |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Metodat e mësimdhënies:** | *Ligjëratat dhe ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme. Punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur).* |
| **Metodat e vlerësimit:** | *Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është: 50%.*<br>*Vijueshmëria e studentit 10%;*<br>*Detyrat grupore të kryera në shtëpi 90%;* |
| | |
| **Literatura primare:** | 1. ***"Technical Communication"**, By **John M. Lannon, Laura J. Gurak, 2020, PEARSON,***<br>2. John W. Davies, Communication Skills. A Guide for Engineering and Applied Science Students, Prentice Hall, 2011. |
| **Literatura shtesë:** | 3. Miller et al, How the World Changed Social Media, UCL Press, 2016<br>4. Majlinda Nishku, Si të shkruajmë: procesi dhe shkrimet funksionale, CDE, Tiranë, 2004. |

**Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes**

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.*
*Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.*
*Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.*
*Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*